



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.54

10 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.308, datë 21.4.2011

Për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për QKR-në.....

2287

Vendim i GJK
nr.13, datë 22.4.2011

Me objekt, konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.3809, datë 21.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.....

2287

VENDIM
Nr.308, datë 21.4.2011

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS, PËR QKR-NË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 10 e 17 të ligjit nr.10 355, datë 27.11.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, zëri “Investime kapitale të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekësh, për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Kjo shumë të përballohet nga pakësimi i fondit në programin “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësinë industriale”, zëri “Investime kapitale të brendshme”, nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.13, datë 22.4.2011

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“	
Petrit Pllloçi	Anëtar	i “	“	
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“	
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“	
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“	
Admir Thanza	Anëtar	i “	“	

me sekretare Blerina Çinari, në datën 23.11.2010 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27/12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ali Tafalla

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga Orjeta Cefa dhe Violeta Lita, me autorizim.

Zyra e përmbarimit Tiranë, përfaqësuar nga Rrok Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.3809, datë 21.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara: Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, që u shpreh për rrëzimin e kërkesës, zyrën e përmbarimit Tiranë që e la në çmimin e gjykatës si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. **Kërkuesi** ka qenë punonjës i administratës doganore në kategorinë C2, të kontrollit fizik në degën e doganës Kapshticë. Me aktin administrativ nr.9563, datë 2.8.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ai është larguar nga puna me motivacionin: “Shkurtim i vendit të punës”. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadinë me objekt: *Shfuqizimi i aktit administrativ nr.9563, datë 2.8.2006, kthimi në vendin e mëparshëm të punës dhe pagesa për gjithë kohën e qëndruar pa punë deri në rikthimin në punë.*

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3809, datë 21.5.2007, është shprehur për pranimin e pjesës së padisë, *anulimin e aktit administrativ të largimit nga puna të kërkuesit, detyrimin e palës së paditur të përfshijë paditësin në listat e pritjes për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, detyrimin e palës së paditur për t'i njohur paditësit të drejtat e vendit të mëparshëm të punës, si dhe t'i paguajë pagën e një viti pune, rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.*

3. Vendimi gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 mori formë të prerë, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) nuk ushtroi të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1393, datë 23.5.2008, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.3809, datë 21.5.2007. Me shkresën nr.11160 prot, datë 16.9.2008, zyra e përmbarimit Tiranë ka njoftuar vënien në ekzekutim të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit nr.1393, datë 23.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Me shkresën nr.11337/1 prot, datë 29.9.2008, DPD-ja përgjigjet se ajo i është drejtuar me kërkesë gjykatës me objekt rivendosjeje në afat të së drejtës për të paraqitur ankim si palë e paditur ndaj vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007. Me vendimin nr.69, datë 18.3.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së DPD-së. Me vendimin nr.13, datë 3.2.2009, Gjykata e Apelit Tiranë, pas ushtrimit të ankimit nga DPD-ja, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.69, datë 18.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Zyra e përmbarimit Tiranë, me shkresën nr.5263 prot, datë 9.4.2009, pas ekzekutimit të vendimit vetëm për pjesën e dhënies së pagës për një vit, i kërkon DPD-së të përmbushë detyrimin për kalimin një vit në listë pritjeje të kërkuesit. Me shkresën nr.5568, datë 12.4.2010, Zyra e Përmbarimit Tiranë përsërit kërkesën ndaj DPD – së për vënien në listë pritjeje të kërkuesit. DPD-ja, me shkresën nr.5308/1, datë 14.5.2010, ka vënë në dijeni zyrën e përmbarimit Tiranë se vendimi gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 është ekzekutuar.

II

7. **Kërkuesi** më datë 27.8.2010 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykatës) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit të plotë të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.3809, datë 21.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. **Kërkuesi**, para Gjykatës ka pretenduar:

8.1 Vendimi gjyqësor nr.3809 nuk është ekzekutuar plotësisht, sepse DPD-ja, përveç dhënies së pagës për një vit, nuk e ka vendosur atë në listë pritjeje dhe nuk i ka njohur të drejtat e vendit të mëparshëm të punës, si: rikthim në vendin e punës, shpërblime, pushime javore dhe vjetore etj.

8.2 DPD-ja ka refuzuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

8.3 Dega e doganës Kapshticë nuk ka pasur shkurtim të pozicionit “Inspektor i kontrollit fizik të kategorisë C2” nga krahasimi i dy organigramave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.612, datë 11.9.2003 “Për strukturën dhe organikën analitike të administratës doganore” dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””.

8.4 Kërkuesi ka provuar në gjykatën e faktit, se gjatë periudhës së listës së pritjes 2006-2007, DPD-ja ka organizuar disa konkurse për vende të lira pune dhe kërkuesit nuk i është ofruar një i tillë.

8.5 Zyra e përmbarimit nuk ka kërkuar forcërisht ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007, konform kërkesave të nenit 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e përmbarimit gjyqësor”.

9. **Subjekti i interesuar, DPD-ja**, ka pretenduar:

9.1 Vendimi gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 është ekzekutuar si përsa i përket pagës për një vit, ashtu dhe përfshirjes së kërkuesit në listë pritjeje. DPD-ja ka zbatuar vendimin gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 duke e lënë në listë pritjeje automatikisht kërkuesin për një periudhë njëvjeçare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””.

9.2 DPD -ja nuk ka asnjë detyrim tjetër të pagesës në vazhdimësi përtej pagës së një viti që ka qëndruar në listë pritjeje dhe as për rikthimin në punë të tij. Pasojat e anulimit të aktit të largimit nga puna gjykata i ka lidhur me lënien në listë pritjeje për një periudhë njëvjeçare dhe pagimin e pagës për një vit.

9.3 Referuar vendimeve unifikuese nr.8 dhe nr.10, datë 12.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” nuk shtrihet për punonjësit e administratës doganore. Kërkuesi ka bërë një interpretim të situatës së tij, duke u mbështetur në statusin e nëpunësit civil, por Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk i është referuar këtij ligji në trajtimin e çështjes. Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor momentin e rikthimit në punë e lidhin me ekzistencën e vendeve të lira të punës, dhe jo me një rikthim taksativ në vendin e mëparshëm të punës.

9.4 Dega e doganës Kapshticë ka pasur një reduktim prej 3 vetash të numrit të punonjësve të kategorisë “doganier i kontrollit fizik C2”, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””, prandaj dhe largimi i kërkuesit është bërë për shkak shkurtimi të vendit të punës.

9.5 Deri më datën 2.8.2007, kur kërkuesit i mbaronte periudha e listës së pritjes, nuk ka pasur asnjë shtesë të numrit të punonjësve për kategorinë C2 të kontrollit fizik në degën e doganës Kapshticë, ku ai bënte pjesë.

10. **Subjekti i interesuar, zyra e përmbarimit Tiranë** ka pretenduar:

10.1 Ka kryer një sërë veprimesh përmbarimore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.05.2007, po për çdo rast përgjigjet e DPD -së kanë qenë negative.

10.2 Ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.05.2007, për sa i përket vënies në listë pritjeje të kërkuesit nuk mund të realizohet, se kjo zyrë është vënë në lëvizje në vitin 2008, kur periudha e vënies së kërkuesit në listën e pritjes, sipas këtij vendimi, mbaronte me datë 2.8.2007.

III

Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga organet e administratës publike

11. Faza ekzekutive e një vendimi gjyqësor konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr.2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr.13, datë 14.4.2010 dhe nr.14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Parimi i shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, të forcojë dhe të zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë (*shih vendimin nr.8, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kërkuesi pretendon mosekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 përsa i përket rikthimit në punë ose pagesës në vazhdimësi deri në rikthimin në punë.

15. Sipas DPD-së, gjykata nuk është shprehur për rikthim në punë të kërkuesit ose pagë në vazhdimësi; për këtë arsye ka pranuar dhe padinë në mënyrë të pjesshme. Të drejtat e kërkuesit mbarojnë me dhënien e pagës për një vit sipas vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007.

16. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 është shprehur për “*pranimin e pjesshëm të padisë - anullimin e aktit administrativ të largimit nga puna të kërkuesit, - detyrimin e palës së paditur të përfshijë paditësin në listat e pritjes për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, detyrimin e palës së paditur t’i njohë paditësit të drejtat e vendit të mëparshëm të punës, si dhe t’i paguajë pagën e një viti pune, rrëzimin e padisë për pjesën tjetër*”.

17. Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për rikthim në vendin e mëparshëm të punës ose pagesë në vazhdimësi derisa sa t’i ofrohet një vend pune nuk qëndrojnë, sepse me vendimin gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është shprehur për to.

18. Kërkuesi pretendon mosekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 përsa i përket mosvënies në listë pritje. DPD-ja pretendon se vendimi gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 është ekzekutuar përsa i përket përfshirjes së tij në listë pritjeje, *de jure* dhe *de facto*.

19. Gjykata vlerëson se duhet të ndalet në legjislacionin për procedurat e vënies në listë pritjeje të personelit doganor, si dhe statusin e punonjësve të doganave.

20. Para daljes së vendimit unifikues nr.8, datë 12.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, DPD-ja dhe degët e saj zbatonin procedurat e statusit të nëpunësit civil për rekrutimin, kalimin në listë pritjeje ose largimin nga shërbimi civil të punonjësve doganorë. Me këtë vendim unifikues u interpretua se ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” nuk shtrihet për punonjësit e administratës doganore. Pas daljes së këtij vendimi administrata

doganore trajtohet me ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe aktet të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

21. Kërkuesi është larguar nga puna më datë 2.8.2006 dhe vendimi gjyqësor nr.3809 është i datës 21.5.2007, pra përpara daljes së vendimit unifikues nr.8, datë 12.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

22. Gjykata vëren se përsa i përket shkurtimit të vendeve të punës, si rrjedhojë e riorganizimeve, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””, pika 11.12.2, përcakton: *“Kur vendet e punës shkurohen, si rrjedhojë e riorganizimit ose e reformave, (...) punonjësit e shkurtuar, të të gjitha kategorive, (...) futen në listë pritjeje për një periudhë 1-vjeçare, për t’u emëruar pa konkurrim, me kusht që të plotësojnë kërkesat e vendit të punës, të mbetur vakant”*.

23. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se punonjësit doganorë, të shkurtuar për shkak riorganizimi ose për shkak reforme, trajtohen si punonjës të përfshirë në listë pritjeje, me disa të drejta që i rrjedhin nga ky status. Të drejtat e lidhura me këtë status përfshijnë trajtimin me një vit pagë dhe ofrimin e një vendi pune në përputhje me kërkesat e përshtatshmërisë për atë vend pune, pa konkurs.

24. Gjykata vëren se për ndjekjen e procedurave, për vendosjen e një nëpunësi në listë pritjeje, ekzistojnë dhe dispozita të tjera të dala në zbatim të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”, të cilat e qartësojnë këtë moment. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.360, datë 14.7.2000 “Për lirim nga shërbimi civil”, pika 7-10, përcakton se: *“ (...) Nëpunësit e larguar, në kuadër të ristrukturimit të institucionit regjistrohen në një listë pritjeje që mbahet nga Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamenti, drejtoria ose seksioni i personelit, drejtoria e personelit e institucioneve të pavarura, të cilët, në rastin e parë, ku rezulton një vend i lirë dhe nëse kandidati plotëson kërkesat e veçanta për vendin e lirë, e emërojnë në atë vend, pa konkurrim”*.

25. Gjykata vlerëson se administrata publike, përgjegjëse për zbatimin e legjislationit në fjalë, për të zbatuar sa më saktë konceptin e listës së pritjes, duhet të respektojë disa standarde transparence, siç është ekzistenca e listës së pritjes, regjistrimi i punonjësve në listë pritjeje, identifikimi i këtyre punonjësve dhe njoftimi i tyre për kalimin në listë pritjeje. Sipas kësaj Gjykate, njoftimi i palëve të interesuara për përmbajtjen e aktit administrativ individual, në veçanti për pasojat juridike që rrjedhin prej tij, është një aspekt që garanton një proces të rregullt ligjor, por edhe të drejtën kushtetuese të qytetarëve për informim dhe transparencë. Prandaj dhe njoftimi i personave për vënien në listë pritjeje, përbën një standard të detyrueshëm për zbatim nga organet e administratës publike.

26. Gjykata çmon se vënia e një personi në listë pritjeje duhet të jetë efektive dhe jo formale, në të kundërt, personat e interesuar kanë të drejtë të ndjekin rrugën e ankimit gjyqësor, për të përfituar të drejtat që i gëzojnë për shkak largimi nga vendet e punës jo për faj të tyre, por për arsye ristrukturimi ose reforme institucionale.

27. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se urdhri i largimit nga puna të kërkuesit është mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.172, datë 29.3.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.360 të sipërcituara. Kërkuesi e ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor urdhrin e largimit nga puna. Me vendimin gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur ndërmjet të tjerash, *detyrimin e palës së paditur të përfshijë paditësin në listat e pritjes për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës*.

28. Kjo Gjykatë, gjithashtu, vëren se DPD-ja nuk e ka vënë efektivisht kërkuesin në listë pritjeje. Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është provuar se DPD-ja ka shpallur vende të lira pune për pozicionin e tij, gjatë kohës, që sipas urdhrin të largimit nga puna, duhej të ishte në listë pritjeje.

29. Gjykata vlerëson se gjatë seancës gjyqësore DPD-ja nuk provoi, nëpërmjet një akti administrativ individual ose çfarëdo shkrese njoftimi, se kërkuesi ishte vënë *de facto* dhe efektivisht në listë pritjeje dhe se ishte njoftuar për statusin e tij si punonjës i doganave në listë pritjeje.

30. Gjykata vlerëson se DPD-ja, e cila kishte nxjerrë një urdhër të largimit nga puna të kërkuesit për shkak ristrukturimi, duhej ligjërisht ta trajtonte atë me 1 vit pagë dhe me vendosjen në listë pritjeje nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si të drejta që kërkuesi i përfitonte nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

31. Gjykata vlerëson se në kontekstin e legjislacionit në fuqi, të analizuar më lart, përse i përket listës së pritjes (*shih paragrafët 22 dhe 24*), njoftimi i vënies në listë pritjeje të kërkuesit dhe vënia në listë pritjeje efektivisht janë detyrime ligjore që DPD-ja duhet t'i kishte plotësuar.

32. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur një qëndrim ligjor nga DPD-ja për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. DPD-ja e gjendur para një vendimi gjyqësor, që ka konfirmuar të drejtën ligjore të kërkuesit për ta vënë në listë pritjeje, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të treguar vullnetin e saj, për të zbatuar ligjin dhe për të ekzekutuar vendimin e gjykatës.

33. Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, Gjykatës i rezulton se pas fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 nga zyra e përmbarimit, kërkuesit i është dhënë një vit paga, por jo nga periudha e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në një vit, siç parashikon legjislacioni në fuqi. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se edhe për këtë arsye bie dhe argumenti i DPD-së i përdorur gjatë seancës gjyqësore, sipas të cilit gjatë kohës që është paguar një vit, kërkuesi ka qenë *de facto* në listë pritjeje. Data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës ka qenë 2.8.2006, prandaj dhe kërkuesi në një situatë ligjore korrekte, ku një punonjës largohet nga puna për shkak ristrukturimi, do të duhej të trajtohej me pagesën e një viti dhe me qëndrimin në listë pritjeje nga data 2.8.2006 deri më 2.8.2007, periudhë gjatë së cilës, nëse do të kishte vende pune të lira, do të duhej t' i ofroreshin të parit atij, si i larguar për shkak ristrukturimi.

34. Gjykata gjithashtu vëren se vendimi gjyqësor nr.3809, datë 21.5.2007 është marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 21.5.2007, pra edhe rreth 2 muaj nga plotësimi i afatit 1-vjeçar nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës për kërkuesin dhe njëkohësisht edhe nga plotësimi i afatit 1-vjeçar që ai duhet të qëndronte në listë pritjeje. Po kështu, kjo Gjykatë konstaton se ekzekutimi i vendimit në fjalë është kërkuar pranë zyrës së përmbarimit Tiranë pas mbarimit të periudhës së listë pritjes. Për këtë arsye kjo zyrë në seancë gjyqësore pretendoi se ky vendim tashmë është i paekzekutueshëm.

35. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kjo çështje i përket juridiksionit të gjykatës së zakonshme, dhe jo juridiksionit kushtetues, në përputhje me nenin 609/1 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet: *“Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit, që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas”*.

36. Si përfundim, në vijim të arsytimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se legjislacioni në fushën e punësimit të personelit doganor e detyron administratën doganore të standardizojë verifikueshmërinë e listës së pritjes. Kjo Gjykatë vlerëson se mosekzekutimi i plotë i vendimit gjyqësor të formës së prerë ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.3809, datë 21.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përsa i përket mosvënies në listë pritjeje të kërkuarit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi.

Anëtar kundër: Vitore Tusha, Vladimir Kristo.

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuari Ali Tafalla, me aktin administrativ nr.9563, datë 2.8.2006 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), është larguar nga puna me motivacionin “për shkurtim të vendit të punës”.

2. Kërkuari i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, duke kërkuar anulimin e aktit (urdhrit) si më sipër, rikthimin në punën e mëparshme dhe dhënien e pagës për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë. Në padinë e tij, si dhe gjatë seancës gjyqësore, kërkuari ka argumentuar se motivi i largimit nga puna ka qenë i pabazuar sepse pala e paditur, pas largimit të tij, ka punësuar njerëz të tjerë në pozicionin që pretendohet si i shkurtuar. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar se atij nuk i është ofruar asnjë pozicion tjetër pune i së njëjtës kategori ose i një shkalle më të ulët brenda sistemit doganor, duke mos respektuar në këtë mënyrë detyrimet që burojnë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor””. Kërkuari, siç rezulton edhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, ka argumentuar se pala e paditur ka patur vende pune të lira.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, megjithëse i ka pranuar të mirëqena prapësimet e kërkuarit, në vend që të dispononte për thelbin e kërkesës, që është rikthimi në punën e mëparshme, i ka kaluar kufijtë e padisë duke u shprehur edhe për gjëra që nuk i janë kërkuar. Në këtë mënyrë ajo ka disponuar mbi padinë, çka do ta bënte të parregullt procesin e zhvilluar në këtë gjykatë, në eventualitetin e një kërke të kësaj natyre para Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr.8/2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës ka vendosur kryesisht, jashtë objektit të padisë, detyrimin e palës së paditur të përfshijë paditësin në listat e pritjes për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Gjykata ka pranuar padinë vetëm në pjesën që bën fjalë për pagën e një viti, duke rrëzuar kërkesën kryesore, atë të kthimit të paditësit në vendin e mëparshëm të punës.

5. Me vendimin nr.1393, datë 23.5.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Zyra e përmbartimit e ka venë menjëherë në lëvizje çështjen, duke kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. DPD-ja ka pretenduar se e ka ekzekutuar vendimin e gjykatës, si përsa i përket detyrimit për dhënien e pagës për 1 vit, ashtu dhe për pjesën tjetër, vendosjen e kërkuarit në listë pritjeje.

6. Zyra e përmbartimit të Tiranës ka pretenduar se vendimi i gjykatës është zbatuar në të gjitha ekstremitetet, me përjashtim të detyrimit për vendosje të kërkuarit në listë pritjeje që, sipas kësaj zyre është objektivisht i pakzekutueshëm.

Pikërisht për të vërejtur cenimin e procesit të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit plotësisht të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

7. Shumica argumenton në vendimin e saj se procesi duhet konsideruar i parregullt, përderisa nuk është zbatuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës në pjesën që detyron të paditurin (DPD) që ta vendosë kërkuesin në listë pritjeje për një periudhë 1-vjeçare dhe, për rrjedhojë, kërkesa e bërë në Gjykatën Kushtetuese duhet pranuar si e bazuar.

8. Arsyetimi i shumicës na duket i pambështetur si nga pikëpamja formal juridike, ashtu dhe nga pikëpamja e themelit të çështjes.

Së pari, kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor objektivisht të pazbatueshëm për shkak të rënies në dekadencë të afatit të ekzekutimit në pjesën që bën fjalë për vënien e kërkuesit në listë pritjeje. Zyra e përmbarimit është vënë në lëvizje për ekzekutimin e vendimit në vitin 2008, në një kohë kur afati i përcaktuar nga gjykata kishte përfunduar më datë 2.08.2007?!

Së dyti, mendojmë se, edhe përsa i përket themelit të çështjes, kërkesa është e pabazuar dhe, në këto rrethana, duhej vendosur rrëzimi i saj.

9. Kërkuesi në vazhdimësi ka kërkuar kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Këtë kërkesë e përsëriti dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Procedurat lidhur me listat e pritjes atij nuk i interesojnë aspak. Vendosja e kërkuesit në listë pritjeje është një detyrim që buron nga vendimi i Këshillit të Ministrave, por që nuk i jep zgjidhje kërkesës kryesore të padisë, rikthimin e paditësit në punën e mëparshme. Nga ana tjetër, shkelja e këtyre procedurave është një çështje që mund t'u interesojë organeve përkatëse të administratës shtetërore, për të vënë para përgjegjësisë disiplinore ose administrative personat përgjegjës dhe, në këtë rast, vendimi i gjykatës mund t'i ndihmojë këto organe për shmangien e të metave në zbatimin e ligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore. Gjykata Kushtetuese mbron standardet kushtetuese që garantojnë një proces të rregullt ligjor në sferën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kur këto vendime zgjidhin përfundimisht kërkime që prekin të drejta themelore kushtetuese të individit; në rastin konkret, të drejtën e mbrojtjes kushtetuese të punës (neni 49 i Kushtetutës), të cenuar si pasojë e marrjes së një vendimi për largim nga puna, të kundërshtuar si të paligjshëm.

10. Shkeljet e procedurave administrative, që shoqërojnë procesin e vendimmarrjes për largime ose shkurtime të vendit të punës, edhe në qoftë se janë pjesë e dispozitivit të vendimeve gjyqësore, nuk mund të jenë në asnjë rast pjesë e mbrojtjes juridike kushtetuese për efekt të konstatimit të shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, përderisa ato nuk zgjidhin themelin e kërkesës, në rastin konkret, kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion tjetër të barasvlefshëm. Formalizmi në këto raste dëmton edhe efektivitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Anëtarë: Vitore Tusha, Vladimir Kristo.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 9.5.2011
Doli nga shtypi më 10.5.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 12 lekë